

VENDIM
Nr. 10, datë 20.1.2021

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “GERTI”
SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC
“VARDARI” ME KAPACITET TË INSTALUAR 1972 kw**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a”, nenit 10, pika 3 dhe nenit 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe të nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 20.1.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr.9/6 prot., datë 15.1.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi aplikimin e shoqërisë “Gerti” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “Gerti” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 5 prot., datë 6.1.2021, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC Vardari, me vendndodhje në përroin e Vardarit dhe Valit, dege e përroit të Zallit të Kostenjës, Bashkia Librazhd, qarku Elbasan.

- Shoqëria “Gerti” sh.p.k. është regjistruar pranë QKB-së në datën 17.3.2000 konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar, me statusin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.

- Nga analiza e dokumentacionit në fazën e fillimit të procedurave të licencimit në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, për shoqërinë “Gerti” sh.p.k., rezulton se subjekti plotëson kryesisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formatit dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, germat: “a”, “b”, “c”. Plotësuar;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germat: “c”, “e”, “f”, “g”. Plotësuar;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germat: “b”, “d”. Plotësuar;
- Dokumentacioni teknik për HEC, neni 9, pika 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”. Plotësuar;
- Leje nga institucione të tjera, neni 9, pika 4.1.5, germat: “a”, “b”, “c”. Plotësuar.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

Neni 9, pika 2, Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor:

- germa “a”/“b” (akti i themelimit/statuti). Pa plotësuar. Shoqëria “Gerti” sh.p.k. në vijim do të depozitojë Aktin e Themelimit dhe Statutin e saj në ERE;

- germa “d” (vërtetimi nga prokuroria dhe gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë). Plotësuar pjesërisht. Sa konstatuar në ekstraktin e QKB-së shoqëria veprimtarinë e saj e ushtron edhe në zonën e Librazhdit (zona ku do të zhvillohet projekti i HEC Vardari). Si e tillë, kjo shoqëri, përveç vërtetimeve të gjendjes gjyqësore të lëshuara nga qarku i Dibërës (ku ndodhet selia kryesore e saj), duhet të përcjelle në ERE edhe ato të qarkut të Elbasanit;

- Në vijim shoqëria do të depozitojë në ERE vërtetimet e Gjykatës dhe Prokurorisë së qarkut Dibër për administratorin e saj, dhe vërtetimet e Gjykatës dhe Prokurorisë së qarkut Elbasan, për vetë shoqërinë dhe administratorin e saj.

Neni 9, pika 3, dokumentacioni financiar dhe fiskal:

- germa “a” (vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore). Plotësuar pjesërisht. Shoqëria në vijim do të përcjelle në ERE vërtetimin në lidhje me sigurimet shëndetësore dhe shoqërore në formën standarde në të cilën lëshohen këto lloj vërtetimesh;

- germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe strukturën e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, etj.). Plotësuar pjesërisht. Duke qenë se vërtetimi i gjendjes së llogarisë bankare, që shoqëria ka depozituar në ERE, nuk arrin të mbulojë të gjithë vlerën e investimit, në vijim shoqëria do të përcjellë dokumentacion financiar mbështetës për financimin e HEC Vardari, do të njoftohet shoqëria që në bazë të nenit 10, pika 10 dhe 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, që t’i paraqesë ato brenda afateve.

- Në përfundim të afatit të kontratës së qirasë (data e përfundimit 7.8.2027) me Bashkinë Librazhd, do t’i kërkohet shoqërisë ta depozitojë atë me afate të rinovuara, një muaj pas nënshkrimit të rinovimit. Në vijim, do t’i kërkohet shoqërisë të përcjellë në ERE edhe finalizimin e procedurës në lidhje me heqjen nga fondi pyjor kullësor të sipërfaqes së përcaktuar për HEC Vardari.

- Në përfundim të afatit të lejes së shfrytëzimit të burimit ujor (data e përfundimit 16.10.2022), do t’i kërkohet shoqërisë ta depozitojë atë me afate të rinovuara, një muaj pas nënshkrimit të rinovimit të saj.

- Shoqërisë “Gerti” sh.p.k. do t’i kërkohet informacioni në lidhje me fillimin e punimeve për ndërtimin e HEC, apo në fazën në të cilën ndodhet projekti, në mënyrë që të mundësohet një llogaritje më korrekte e vlefshmërisë së lejes mjedisore, në këtë aplikim.

Kontrata nr. 118 rep., nr. 62/2 kol., datë 24.1.2018, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit ‘Vardari’ me kapacitet 1.972 mw, në përroin e Vardarit dhe Valit, degë e përroit të Zallit të Kostenjës, Bashkia Librazhd, qarku Elbasan”, lidhur midis MIE-s dhe mbajtësit të miratimit shoqërisë “Drini Bulqize” sh.p.k., të drejtat dhe detyrimet e të cilit i janë transferuar më pas shoqërisë “Gerti” sh.p.k., nëpërmjet amendimit të kontratës me nr. 1818 rep., dhe nr. 388/2 kol., datë 24.12.2020, “Për kontratën e ndërtimit, shfrytëzimin dhe administrimit të hidrocentralit ‘Vardari’ me kapacitet 1.972 mw, në përroin e Vardarit dhe Valit, degë e përroit të Zallit të Kostenjës, Bashkia Librazhd, qarku Elbasan”, ka një afat 49-vjeçar, por nga ana tjetër shpjegojmë se ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 5, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk mund të japë, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, një licencë me afat më të madh se 30 vjet.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Gerti” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Vardari”; me kapacitet të instaluar 1972 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti